



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije - Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Numër: 018-130
Datë: 20.09.2023

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 34/18 nëntor 2022), nenit 5 shtojca 1 paragrafi 7 nënparagrafi 7.1 i Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 15.06.2023, neni 15 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 42 paragrafi 4 dhe 8 i Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 25 paragrafi 1 dhe 5 i Ligjit për Veprimtari Kërkimor-e Shkencore, nenit 23 i Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nenit 15 nënparagrafi 1.5 i Udhëzimit administrativ nr. 8/2017 për Institutin Pedagogjik të Kosovës, nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 dhe nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016,) dhe opinionit ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) nr.860 të dt. 01.08.2023 nxjerr:

V E N D I M

Për shfuqizim të Akt emërimit

1. Shfuqizohet Akt emërimi i dt.15.12.2013 i z. Nezir Çoçaj, në pozitën: Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës.
2. I lartpërmenduri do të sistemohet përshtatshëm sipas legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi dhe ka efekt juridik me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Pas analizimit të opinionit ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) nr.860 të dt. 01.08.2023, legjislacionit përkatës të Shërbimit Civil dhe Akt emërimit të dt.

15.12.2013 me afat të pakufizuar, janë identifikuar parregullsi dhe shkelje esenciale të dispozitave ligjore, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, respektivisht Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, sa i përket emërimit dhe kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, mandatit të z. Nezir Çoçaj, në pozitën: Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

MASHTI përmes shkresës së dt.08.06.2023 me nr.ref.01B-065, ka kërkuar opinion ligjor nga DMZP në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë dhe afatshmërisë së pozitive të larta drejtuese, pozitë që ka mbajtur edhe Nezir Çoçaj me Akt emërimit të dt. 15.12.2013 në pozitën: Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Në analizën e Ligjit për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe Udhëzimit administrativ nr. 8/2017 për Institutin Pedagogjik të Kosovës, statusi i institucionit përcaktohet si institucion i pavarur publik kërkimor shkencor.

Me datën 01.08.2023 DMZP, ka dhënë opinion ligjor përmes shkresës me nr.860, me të cilin ka konstatuar se Akt emërimi i dt. 15.12.2013 në pozitën: Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, është i kundërligjshëm.

Gjithashtu, ka konstatuar se është përgjegjësi e MASHTI-t të ndërmer veprime dhe masa të nevojshme për vendosjen e ligjshmërisë për rastin e pozitës së Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, pasi që as me Ligjin nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe as me Ligjin nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nuk parashihet që kjo pozitë ta ketë mandatin e përhershëm me kohëzgjatje të pacaktuar.

Akt emërimi i dt. 15.12.2013, i nënshkruar nga Xhavit Dakaj, ish-sekretar i përgjithshëm i MASHTI, është i paligjshëm, sepse është në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se mandati për pozitën e larta drejtuese është 3 vjeçar, si dhe me nenin 42 paragrafi 4 i Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se kohëzgjatja dhe mandati i pozitive të larta drejtuese është me kohë të caktuar.

Gjithashtu akt emërimi është në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 dhe 5 të Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore, neni 23 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe nenin 15 nënparagrafi 1.5 i Udhëzimit Administrativ nr. 8/2017 për Institutin Pedagogjik të Kosovës ku përcaktohet emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të Institutit pedagogjik të Kosovës.

Meqë, z. Nezir Çoçaj, në pozitën: Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, është në këtë pozitë prej vitit 2013 dhe meqë është konsumuar mandati i pacaktuar me legjislacionin në fuqi, shfuqizohet Akt emërimi i dt. 15.12.2013 dhe z. Çoçaj lirohet nga pozita e Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, por nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për periudhën 3 mujore.

Andaj, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë lidhur me emërimin dhe mandatin e Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përputhje me dispozitat ligjore të lartpërmendura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Z. Nezir Çoçaj;
2. Zyrës së SP/MASHTI;
3. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
4. Institutit Pedagogjik të Kosovës;
5. Divizionit të BNJ /MASHTI;
6. Arkivit/MASHTI.


Arbërie Nagavci, Ministre

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në Komisionin e ankesave në MASHTI, në afat prej tridhjetë ditësh (30), nga dita e pranimit të vendimit.